



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 19/55
Datë: 06.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 korrik 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Ndërmjetësimin e Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës

Republika Kosovo – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada – Government

Ministrie e Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Ministravo Kulturne, Omladina i Sporta – Ministry of Culture, Youth and Sport

KONCEPT DOKUMENT

PËR NDËRMJETËSIM E KONTESTEVE NË FUSHËN E DREJTËS SË AUTORIT

Kapitulli 1: Hyrje

Bazat e Sistemit të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta në Republikën e Kosovës janë vënë me aprovimin e Ligjit të parë për të Drejta e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta (Ligji Nr. 2004/45, përkatësisht rregullojta Nr. 2006/46 e datës 24 Gusht 2006). Ligji i ri dhe aktual, Ligji për të Drejta e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta (LDADDP), Ligji Nr. 04/L-065, i publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 27, të datës 30 Nëntor 2011 si dhe Ligji Nr. 050/L-047 mbi plotësim- ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta në Kosovë janë të garantuara me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta (LDADDP), ndërsa Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta (ZDA) ka këtë veprimtari dhe kompetenca: dhënien e lejes shogotave për administrim kolektiv të të drejtave; marrjen e lejes së dhënë Shogatës për administrim kolektiv të të drejtave në rast të mos përbushjes së kriterëve të parapara me ligji mbikëqyrjen e veprimtarisë dhe aktiviteve të shogotave për administrim kolektiv të të drejtave; promovimin dhe ndërmarrjen e aktiviteve për dhënien e informatave të duhura autorëve dhe bartësve të të drejtave.

Duke pas parasysh që legjislacioni për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta është mjaft dinamik dhe paraqiten ndryshime të vazhdueshme, nga kjo ka rezultuar nevoja që të bëhen plotësime dhe ndryshime të LDADDP-së me qëllim të përcjelljes së legjislacionit të BE-së dhe atij ndërkombëtar.

Zhvillimet dinamike në fushën e të drejtës së autorit kanë bërë që Qeveria e Republikës së Kosovës të i propozoj Parlamentit të Kosovës të miratojë Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, me qëllim që t'i përgjigjet këtyre zhvillime moderne dhe të harmonizojë legjislacionin kombëtar me atë të BE-se dhe ndërkombëtar. Ky ligj vetëm sa ndryshon dhe plotëson LDADDP-në. Ligji i ri i LDAP-së është mjaft i thuket dhe rregullon disa fusha të së drejtës së autorit, si për shembull përkufizimi i termeve të reja, programeve kompjuterike shtohen si krijimtari e cila gëzon mbrojtje ligjore më të gartë, rregullohet çështja e veprave jetime për përdorim nga institucionet publike, afatet kohore të procedurës së ndërmjetësimit dhe shumë çështje tjera me rendësi për fushën e së drejtës së autorit dhe drejtave të përafërta.

Për më tepër, LDADDP është plotësuar dhe ndryshuar me qëllim harmonizimit të tij të plotë, me këtë rast janë hasur zbrazëtira dhe janë ndryshuar dispozita të ndryshme, ndër to është rregulluar dhe çështja lidhur me ndërmjetësimin në të drejtën e autorit.

Në kuadër të ndryshimeve, janë përfshirë edhe dispozitat të cilat parashohin procesin e ndërmjetësimit në fushën e të drejtës së autorit, përkatësisht në çështjet që kanë të bëjnë me përcaktimin e tarifave të përgjithshme. Ndërmjetësimi, është një formë e zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, një mënyrë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis dy ose më shumë palëve. Ndërmjetësimi është një proces dinamik, i strukturuar dhe interaktiv, ku një palë e tretë neutrale ndihmon palët të negociojnë me qëllim të arritjes se një zgjidhjeje. Ndërmjetësuksi përdor një larmi teknikash për të udhëhequr procesin në një drejtim konstruktiv dhe për të ndihmuar palët

të gjejnë zgjidhjen e tyre optimale. Një ndërmjetësues është lehtësues, në atë që menaxhon ndërveprimin midis palëve dhe lehtëson komunikimin e hapur.

Ndërmjetësimi konsiderohet si një alternativë me e dëshirueshme e zgjidhjes se kontestëve, kjo për arsye se ndërmjetësimi konsiderohet të jete më pak i kushtueshëm, pasi që procedura e ndërmjetësimit zgjat shumë më pak se procedura gjyqësore; ndërmjetësimi është konfidencial për dallim prej seancave gjyqësore të cilat ne parim janë të hapura për publikun; zakonisht palët pajtohen me vendimin e marr ne procedurën e ndërmjetësimit etj.

Ndërmjetësimi si proces është shumë i rëndësishëm dhe në përgjithësi zbatohet dhe realizohet në bazë të Ligjit Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim, për të gjitha kontestet përfshirë edhe kontestet në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përfaqëta, dhe procesi i ndërmjetësimit i veçantë që është paraparë në përcaktimin e tarifave të përgjithshme dhe i cili proces realizohet në bazë të Ligjit për të drejtën e autorit dhe të drejtave të përfaqëta dhe të Rregullores për Ndërmjetësim të Kontestëve në Fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përfaqëta. Kur jemi te ndërmjetësimi në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtat e përfaqëta, përkatësisht Ligji për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përfaqëta, ka paraparë ndërmjetësimin posaçërisht në procesin e përcaktimit të tarifave të përgjithshme për shfrytëzimin e lëndës së mbrojtur me të të drejtat e autorit dhe të drejtat e përfaqëta, kjo e përcaktuar me nenin 176 të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përfaqëta. Procesi i përcaktimit të tarifave të përgjithshme realizohet përmes tre fazave, faza e parë ajo e negociatave, faza e dytë faza e ndërmjetësimit dhe faza e tretë nëse dy të parat dështojnë faza e ndërhyrjes së qeverisë përkatësisht miratimi i tarifave nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Vlen të përmendet fakti që ndërmjetësimi i rregulluar me Ligjin për të Drejtën e Autorit dhe në detale i përcaktuar me Rregulloren për Ndërmjetësim të Kontestëve në Fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përfaqëta, nuk është një proces i cili është shfrytëzuar aq sa duhet nga palët përkatësisht vetëm njëherë është propozuar nga njëra nga Shogatat për Menaxhimin e të Drejtave të Autorit dhe të Drejtave të Përfaqëta në fushën e veprave audio vizuale e njohur me emrin VAPIK, kjo shogatë kolektive ka dërguar një propozim për ndërmjetësim operatorëve kabllorë për të përcaktuar tarifat e përgjithshme por procesi ka përfunduar fare pa filluar pasi që në afatin e paraparë ligjor, operatorët kabllorë nuk janë përgjigjur propozimit të bërë nga ana e VAPIK-ut. Në këtë aspekt mund të themi se procesi i ndërmjetësimit, në përcaktimin e tarifave të përgjithshme nuk është përdorur fare dhe deri më tani nuk është përdorur nga ana e palëve.

Ndryshimi i Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përfaqëta me qëllim që ligji të harmonizohet me direktivat e Bashkimit Evropian është dashtë të ndryshohet edhe neni 176 paragrafi 4 i Ligji Nr. 04/L-065, me qëllim të harmonizimit me Direktivën 98/83/EEC e datës 27 shtator 1993 e cila ka synuar lehtësimin e transmetimit ndërkufitar të programeve audio-vizuale, përkatësisht transmetimit me satelit dhe ritransmetimit kabllorë. Gjithashtu, praktika dhe përdorimi i neni 176, të Ligjit nr. 04/L-065 për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përfaqëta ka sjellë nevojën për ndryshme në Rregulloren për Ndërmjetësim të Kontestëve në

Fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta, me qëllim që procesi i ndërmjetësimit në përcaktimin e tarifave të përgjithshme të zhvillohet sa më lehtë dhe në mënyrë efektive, atëherë kur paraqiten kërkesa nga ana e palëve.

Në kuadër të zbatimit të Rregullores nr. 05/2013 për Ndërmjetësim të Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta, me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka emëruar ndërmjetësit për ndërmjetësimin e kontesteve në lidhje me nenin 176, përkatësisht kontesteve në lidhje me përcaktimin e tarifave të përgjithshme. Ndërmjetësit e emëruar nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me 05.04.2013, si ndërmjetës për të ndërmjetësuar ekskluzivisht në procesin e ndërmjetësimit në lidhje me tarifën e përgjithshme për shfrytëzimin e materialit të mbrojtur me të drejtën e autorit, në këtë aspekt vlen të përmendet fakti që ndërmjetësuesit nuk kanë pas asnjë rast për ndërmjetësim pasi që dy procese të cilat janë zhvilluar për përcaktim të tarifave të përgjithshme njëri ka përfunduar pa filluar procesi i ndërmjetësimit kjo në lidhje me negociatat në mes të Shoqatës VAPIK, për menaxhimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta në fushën e veprave audio-vizuale dhe operatorëve kabllorë në vend.

Kapitulli 2: Përshkrimi dhe përcaktimi çështjes/problemnit kryesor

Shpjegim

Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta sipas nenit 176 u jep të drejtë shoqatave kolektive dhe përfaqësuesve të përdoruesve të të drejtave në bazë të një marrëveshje ndërmjetësuese të propozojnë ndërmjetësim në një kontest lidhur me: konkludimet e një marrëveshje gjithëpërfshirëse; konkludimet e një marrëveshje për ritransmetim kabllor të transmetimeve; përdorimin për më të mirë të personave me nevoja të veçanta; përdorimin me qëllim të mësimi; riprodhimin privat apo të brendshëm; performancën e punimeve zyrtare; incizimet kaimitare të bëra nga organizatat transmetuese; marrëveshjen lidhur me përcaktimin e tarifave të përgjithshme. Në vazhdim ky nen përcakton që ndërmjetësuasi duhet të jetë i pavarur, duhet të sigurojë që të gjitha palët kryejnë negociata me qëllim të mirë, palët të zgjedhin bashkërisht ndërmjetësuesin nga lista e ndërmjetësuesve të caktuar nga Zyra dhe Zyra duhet të definojë në hollësi procedurat e ndërmjetësimit, nivelin e kompetencës profesionale si dhe kushtet tjera që duhet përmbushen.

Me qëllim të zbatimit të nenit 176 të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, që nga viti 2013 është miratuar Rregulloja për Ndërmjetësimin e Kontesteve në fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta. Me anë të kësaj rregullore, përcaktohet procedura e ndërmjetësimit në mes të shoqatave kolektive dhe përfaqësuesve të përdoruesve, në kontestet e parapara me nenin 176 paragrafi LDADP, në lidhje me përcaktimin e tarifave të përgjithshme për shfrytëzimin e materialit të mbrojtur me të

drejtën e autorit. Për më tepër kjo rregullore përcakton nivelin, llojin e edukimit dhe kushtet tjera që një ndërmjetësues duhet t'i plotësoj për të hyrë në listën e ndërmjetësuesve.

Gjatë plotësimit ndryshimit të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtave të Përafërta neni 176 përkatësisht paragrafi 4 është riformuluar ku thuhet që ndërmjetësuesi mund t'i paraqesë palëve propozim për zgjedhjen e mosmarrëveshjes. Supozohet që palët e pranojnë propozimin për zgjidhje të mosmarrëveshjes, në rast se asnjë prej tyre nuk ka shprehur kundërshtim, brenda një periudhe tre mujore nga dërgimi i propozimit. Njoftimi i propozimit dhe i çdo kundërshtimi për të do të dërgohet palëve të përfshira, në përputhje me rregullat e aplikueshme mbi dërgimin e dokumenteve ligjore.

Përpos neni 176, paragrafi 4, është paraqitur nevoja të inkorporohet dhe neni 9 përkatësisht paragrafi 3 i Ligjit Nr. 03/L-057 për Ndërmjetësim, i cili rregulloren çëshjen e fillimit të procedurës së ndërmjetësimit. Ky nen thotë: *“Nëse njëra palë i kërkon palës tjetër që të ndjekë procedurën e ndërmjetësimit dhe kjo e fundit nuk i përgjigjet ftesës në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimit të saj, konsiderohet si mospranim për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit.”* Me rregulloren në fuqi nuk është e regulluar afati kohor se sa kane kohe palët për t'iu përgjigjur kërkesës për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit. Ky nen do të përcaktoje saktë afatin kohor që palët kane ne dispozicion për t'iu përgjigjur kërkesës, dhe në rast të mos përgjigjes atëherë konsiderohet se procesi i ndërmjetësimit nuk ka filluar.

Si rrjedhojë e ndryshim-plotësimit të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta me këtë rast neni 176 përkatësisht paragrafi 4, dhe përfshirjes se neni 9 përkatësisht paragrafi 4 të Ligjit për Ndërmjetësim si rrjedhojë e nevojës së përcaktimit të afatit kohor se sa kane kohe palët të pranojnë ofertën për fillimin e procedurës së ndërmjetësimit, lind nevoja e ndryshim-plotësimit të Rregullores për Ndërmjetësim në Kontestet në fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta.

Politika aktuale

Aktualisht në Republikën e Kosovës është Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta i cili është plotësuar dhe ndryshuar me qëllim të përfrimit me legjislacionin e BE-së, për afërsisht nëntëdhjetë për qind të dispozitave të tij janë në harmoni me këtë legjislacion. LDADP ka rregulluar çështjet kryesore të fushës së të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta.

Politika e ndërmjetësimit në fushën e të drejtës së autorit, zbatohet duke u bazuar në Ligji Nr. 04/L-065 për të Drejta e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, Ligji Nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe Rregullore për Ndërmjetësim të Kontestave në Fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta, akte primare

këto ligjore të cilat kanë rregulluar procedurën për zhvillimin e procedurës për ndërmjetësim në fushën e të drejtës së autorit, dhe Ligji për Ndërmjetësimin i cili është përdorur si akt subsidiar.

Ligjin për Ndryshimi i ligjit për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta ka sjellë nevojën për ndryshimin edhe të politikës së ndërmjetësimit, në aspekt të ndryshimit të aktit nën ligjor i cili rregullon politikën e ndërmjetësimit në fushën e të drejtës së autorit, që është rregulluar me Rregulloren për Ndërmjetësimin e Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta.

Duke pas parasysh gjendjen e zbatimit të drejtave të autorit dhe të drejtave të përfaqëta, nga momenti i hyrjes në fuqi të LDADP-së, në Dhjetor 2011, ZDA, ka ndërmarrë veprime konkrete në funksion të pëmbushjes së obligimeve të veta ligjore dhe me qëllim të materializimit dhe aplikimit të dispozitave të parapara ligjore.

Ligjet dhe aktet nënligjore

1. Ligji Nr. 04/L-065 për të Drejta e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta (LDADP), i publikuar në Gazetën Zyrtare Nr. 27, të datës 30 Nëntor 2011.

LDADP është ligji kryesor i cili rregullon të drejtën e autorit dhe të drejtat e përfaqëta në Republikën e Kosovës, përkatësisht i njëjti rregullon në detaje: të drejtat e autorit që në bazë të pronës intelektuale, u takojnë autorëve përkitazi me veprat e tyre në lëmin e letërsisë, shkencës dhe artit, në vijim e drejta e autorit; pastaj rregullon të drejtat që, në bazë të pronës intelektuale, janë të përfaqëta me të drejtat e autorit, në vijim të drejtat e përfaqëta, që u takojnë, interpretuesve përkitazi me interpretimet e tyre; prodhuesve të fonogramave përkitazi me fonogramet e tyre; producentëve të filmit përkitazi me video-gramet e tyre; shërbyesit medial Audio-vizual përkitazi me transmetimet e tyre; prodhuesve të bazave të të dhënave përkitazi me bazat e tyre të të dhënave; botuesve përkitazi me botimet e tyre; gjithashtu rregullon edhe administrimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përfaqëta; pastaj rregullon mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përfaqëta në gjykatat kompetente; dhe i njëjti rregullon edhe zbatimin e këtij ligji ndaj personave të huaj.

2. Ligj Nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta

Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta me qëllim të harmonizimit me direktivat e Bashkimit Evropian të fushës së të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta.

Ky ligj është në përputhshmëri të plotë me këto direktiva:

- Direktivën 98/83/EEC e datës 27 shtator 1993 e cila ka synuar lehtësimin e transmetimit ndërkufitar të programeve audio-vizuale, përkatësisht transmetimit me satelit dhe ritransmetimit kabllorë (OJL 248, 06/10/1993);
- Direktivën 2001/29/EC të datës 22 maj 2001 mbi harmonizimin e aspekteve të caktuara të të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta në shoqërinë e informacionit (OJL 167, 22/06/2001);
- Direktivën 2001/84/CE e datës 27 shtator 2001, mbi të drejtën e rishijës, respektivisht përfundimin e autorit të një vepre origjinale të artit (OJL 272, 13/10/2001);
- Direktivën 96/9/EC e datës 11 mars 1996, mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave, (OJL 077, 27/03/1996);
- Direktivën 2006/115/EC e datës 12 dhjetor 2006, për drejtat mbi qiradhënien dhe huazimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave e përafërta në fushën e të drejtave pronësore intelektuale (OJ L 376, 27/12/2006);
- Direktivën 2004/48/EC e datës 29 prill 2004, mbi zbatimin e të drejtave pronësore intelektuale, (OJ L 195, 02/06/2004);
- Direktivën 2009/24/EC versioni i kodifikuar e datës 23 prill 2009 e cila ka harmonizuar legjislacionin Evropian në lidhje me mbrojtjen e programeve kompjuterike (OJ L 111, 05/05/2009);
- Direktivën 2011/77/EU të datës 27 shtator 2011 mbi kohëzgjatjen e mbrojtjes së të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta, (OJ L 265, 11/10/2011, p. 1 – 5), e cila direktivë ka ndryshuar Direktivën 2006/116/EC e datës 12 dhjetor 2006 (OJ L 372, 27/12/2006, p. 12-18);
- Direktivën 2012/28/EU e datës 25 tetor 2012 mbi përdorimin e lejueshëm të veprave jetime (OJ L 299, 27/10/2012).

2. Rregullore mbi procedurat e Dhënies, Përkatësisht Marrjes së Lejes Shogqatave për Administrim Kolektiv të të Drejtave të Autorit dhe të Drejtave të Përafërta

Më 12 Korrik 2012, është nxjerrë Rregullorja mbi Procedurat e dhënies, përkatësisht marrjes së lejes Shogqatave për administrim të të Drejtave të Autorit dhe të Drejtave të Përafërta, nr. 1/2012. Në bazë të kësaj rregullore janë licencuar shogqata për administrim kolektiv të drejtave të autorit në Republikën e Kosovës.

3. Rregullore për Ndërmjetësim të Kontestëve në Fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta

Procesi i ndërmjetësimit, ofron zgjidhje alternative të kontestëve të caktuara, për këtë arsye dhe më qëllim të zbatimit të LDADP, është nxjerrë kjo rregullore e cila rregullon procesin e ndërmjetësimit në fushën e të drejtës së autorit, me theks të veçantë ndërmjetësimin në procesin e përcaktimit të tarifave të përgjithshme.

Konkretisht, rregullohet procesi i ndërmjetësimit në përcaktimin të tarifave të përgjithshme për shfrytëzimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta. Kjo rregullore, përcakton procedurën e ndërmjetësimit në mes të shoqatave kolektive dhe përfaqësuesve të përdoruesve, lidhur me arrijtjen e marrëveshjeve gjithëpërfshirëse për tarifën e përgjithshme, për përdorimin e veprave të autorit. Për më tepër, përcakton nivelin, llojin e edukimit, dhe kushtet tjera që një ndërmjetësues duhet t'i plotësoj për të hyrë në listën e ndërmjetësuesve.

Me ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, përkatesisht me Ligj Nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, me nenin e ri 25 të Ligjit Nr. 04/L-065, është ndryshuar edhe neni 176 përkatesisht paragrafi 4, i cili është riformuluar “ku thuhet që ndërmjetësuesi mund t'i paragesë palëve propozim për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Supozohet që palët e pranojnë propozimin për zgjidhje të mosmarrëveshjes, në rast se asnjë prej tyre nuk ka shprehur kundërshtim, brenda një periudhe tre (3) mujore nga dërgimi i propozimit. Njoftimi i propozimit dhe i çdo kundërshtimi për të do t'u dërgohet palëve të përfshira, në përputhje me rregullat e aplikueshme mbi dërgimin e dokumenteve ligjore”. Ky ndryshim i neni ka sjellë nevojën e domosdoshme që të ndryshohet edhe Rregullorja për ndërmjetësim të Kontestëve në Fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta e cila ka pas të përfshirë në vete gjuhën e neni 176, paragrafi 4, të Ligjit nr. 04/L-065 i cili i është ndryshuar. Neni 7, paragrafi 2, i Rregullores për ndërmjetësim i cili thekson me sa vijon: “Propozimi i ndërmjetësuesit konsiderohet i aprovuar nëse palët hyjnë në marrëveshje të ndërsjellë brenda tre muajve pas dorëzimit të propozimit për ndërmjetësim”, është ndryshuar në aspekt të përmbajtjes me nenin 25 të Ligjit të Nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, i cili ka këtë përmbajtje ku thuhet që “ndërmjetësuesi mund të paragesë palëve propozim për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.” Supozohet që palët e pranojnë propozimin për zgjidhje të mosmarrëveshjes, në rast se asnjë prej tyre nuk ka shprehur kundërshtim, brenda një periudhe tre (3) mujore nga dërgimi i propozimit. Njoftimi i propozimit dhe i çdo kundërshtimi për të do ti dërgohet palëve të përfshira, në përputhje me rregullat e aplikueshme mbi dërgimin e dokumenteve ligjore”

Programi aktual

Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, është organ administrativ, që vepron në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe veprimtarinë e saj e ushtron, në bazë të ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Është me rëndësi të potencohet fakti se Zyra, nuk ka kompetenca ekzekutive në kontekst të zbatimit të të drejtave të autorit, respektivisht për të gjitha pretendimet lidhur me shkeljet e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta, autorët dhe mbajtësit e të drejtave duhet të ju drejtohen organeve kompetente, gjykatave, prokurorive kompetente dhe inspektoratit të tregut.

Veprimtaria e ZDA-së konsiston në përcjelljen e legjislacionit evropian dhe ndërkombëtar të fushës së të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta. Fillimisht ZDA ka hartuar aktet nën-ligjore, Rregulloren mbi procedurat e Dhënies, Përkatësisht Marjes së Lejes Shoqatave për Administrim Kolektiv të të Drejtave të Autorit dhe të Drejtave të Përafërta dhe Rregulloren për bazuar në këto rregullore është zhvilluar procedura e licencimit të shoqatave kolektive në Republikën e Kosovës, respektivisht të përzgjedhjes së ndërmjetësuesve, trajnimit dhe emërimit të tyre nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Zyra në mënyrë të vazhdueshme zhvillon aktivitet promovuese për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, duke zhvilluar në këtë mënyrë kampanja vetëdijësuese në teren, në televizionet kombëtare dhe portale elektronike të lajmeve. Në kuadër të promovimit janë mbajtur edhe konferenca dhe trajnime të ndryshme për të drejtën e autorit, dhe është botuar revista "Autori" me tema nga e drejta e autorit dhe të drejtat e përafërta, si dhe janë shpërndarë mijëra broshura informuese për të drejtën e autorit dhe piratërinë.

Vlen të theksohet se komponentë tjetër me rëndësi e ZDA-së është zhvillimi dhe përforcimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me zyrat si motra nga rajoni dhe me gjerë, dhe pjesëmarrja në konferenca ndërkombëtare. Është mirë të përmendet bashkëpunimi i shkëlqyer me Zyrën Shqiptare për të Drejtën e Autorit, pastaj bashkëpunimi me Zyrën për Pronësi Intelektuale të Republikës së Sllovenisë, dhe kontaktet e vazhdueshme me Zyrën Hungareze dhe Daneze dhe së fundi edhe me Zyrën për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta të SHBA-ve.

Ne lidhje me procedurën e ndërmjetësimit, ZDA fillimisht ka hartuar Rregulloren për Ndërmjetësim të Kontesteve në fushën e se drejtës se autorit, me qëllim të zbatimit të ligjit.

Në bazë të kësaj rregulloreje ZDA ka disa kompetenca, shembull neni 3.4 i kësaj rregullore përcakton se ZDA: *“Zyra e dergon kërkesën tek pala tjetër, nëse palët e marrëveshjes së ndërmjetësimit nuk e kanë dorëzuar kërkesën së bashku. Në rastet kur kërkesa nuk përmban informatat e nevojshme që të kontaktohet pala tjetër, Zyra i drejtohet palës që e ka dorëzuar kërkesën për të ofruar informacionin që mungon.”* Kjo është një nga kompetencat e ZDA-së në realizimin e ndërmjetësimit në kontestet në fushën e së drejtës së autorit.

Në kuadër të procesit të ndërmjetësimit me qëllim të përcaktimit të tarifave të përgjithshme, ZDA, ka qenë e përfshirë vetëm në fillim të procedurës së ndërmjetësimit përkatësisht kur Shoqata për Menaxhimin e të Drejtave të Autorit dhe të Drejtave të Përafërta VAPIK i ka bërë propozim për ndërmjetësim operatorëve kabllorë në Republikën e Kosovës, të cilët nuk janë përgjigj në afatin e paraparë ligjor dhe si rezultat procesi i ndërmjetësimit ka përfunduar ende pa filluar dhe pa u përfshirë ndërmjetësit e emëruar nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Programi aktual i punës së Zyrë për të Drejtën e Autorit dhe vetë procesi i ndërmjetësimit zhvillohet konform të planit të punës për vitin 2018, i cili plan është bërë me qëllim të zbatimit të politikave afatmesme të ZDA-së, në kuadër të të cilit janë paraparë aktivitete, me qëllim të përmbyshjes së detyrave dhe obligimeve që dalin nga LDADP, dhe ku është përfshirë edhe trajtimi i gëshjes së ndërmjetësimit përmes koncept dokumentit i cili pas përfundimit do të dërgohet në qeverinë e Republikë së Kosovës për miratim.

Shpenzimet aktuale

ZDA është institucioni kryesor për bërgjen e politikave të përgjithshme shtetërore për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta, respektivisht vepron në kuadër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe ka statusin e departamentit në kuadër të kësaj ministrie.

Në kuadër të shpenzimeve të ZDA-së, fillimisht do theksuar që ZDA nuk ka kod buxhetor dhe se shpenzimet e ZDA-së kryesisht ndërliidhen me shpenzimet për drejtorin, tre zyrtarë dhe asistenten, respektivisht shpenzime në paga dhe mëdiqje si dhe shpenzimet për aktivitet e zyrës të cilat kryesisht ndërliidhen me aktivitete për promovimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta, si dhe ndjeke të trajnime të ndryshme të cilat deri më tani kanë qenë të mbuluara nga ana e projekteve të ndryshme të BE-së për fushën e Pronësisë Intelektuale.

Në liidhje me shpenzimet për procesin e ndërmjetësimit që mund të zhvillohet në bazë të Rregullorës për ndërmjetësim të Kontestave në Fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta, nuk ka shpenzime të cilat paraqiten për Zyrën për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, përkatësisht pasi që Zyra shërben vetëm si sekretarit, dhe se palët i paguajnë vet shpenzimet e tyre të cilat paraqiten gjatë procedurës së ndërmjetësimit. Për këtë arsye janë paraqitur vetëm shpenzimet përkatësisht në kuadër të vetë pagave të drejtorit, tre zyrtarëve dhe një asistente të ZDA-së. Nuk ka shpenzime tjera shesë të cilat i ngarkohen buxheut të shtetit apo të cilat duhet të bëhen nga ana e ZDA-së apo e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Në këtë aspekt në tabelën 1, paraqiten shpenzimet për paga për punëtorët e Zyrës për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, për vitin e kaluar 2017, për vitin aktual 2018 dhe për vitin në vijim 2019.

Kategoria e shpenzimeve	Shpenzimet në vitin paraprak 2011	Buxheti për vitin 2018	KASH për vitin 2019
Buxheti i MKRS-së			
- paga dhe mëditje			
- shpenzime materiale			
Buxhetet tjera	-	-	-
Financimi nga donatorët	-	-	-
Shpenzimet e drejtpërdrejta nga MF	-	-	-
Gjithsejtë			

Tabela 1.

Shpenzimet e prezantuara në tabelë janë vetëm për shpenzimet e stafit të ZDA-së me buxhet të lejuar. Janë përlllogaritur të ardhurat personale për dymbëdhjetë muaj të vitit 2017 për drejtorin dhe tre zyrtarë të lartë, një asistente e ZDA-së dhe shpenzimet materiale për aktivitetet e realizuara me qëllim të promovimit të drejtës së autorit.

Ndërsa sipas KASH për vitin 2019, janë të përlllogaritura të ardhurat personale për stafin e zyrës duke shtuar kështu edhe një zyrtar konform rregullores së re të MKRS-së, dhe shpenzimet materiale të cilat do të bëhen me qëllim të promovimit të mëtejshëm të drejtës së autorit si dhe realizimi të aktiviteve promovuese.

Vlerësimi plotësues i politikës aktuale

Politika aktuale për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta është krijuar dhe zbatuar nga ana e ZDA-së në bashkëpunim të ngushtë me institucionet për zbatimin e ligjit për të drejta të autorit dhe të drejtat e përafërta. Në këtë aspekt ka pas një bashkëpunim të ngushtë me Inspektoratin e Tregut i cili ka për obligim ligjor, sipas ligjit mbi inspektoratin e tregut dhe LDADP-së, mbikëqyen e zbatimit të LDADP-së në territorin e Republikës së Kosovës.

Politikat aktuale janë zbatuar gjithashtu përmes një bashkëpunimi të ngushtë me Doganën e Kosovës, e cila mbikëqyrë zbatimin e LDADP në pikat doganore. Në këtë drejtim, ngushtë është bashkëpunuar edhe me Policinë e Kosovës, përkatësisht politikat aktuale në fushën e të drejtës së autorit janë harmonizuar me Policinë e Kosovës nga 1 Janari i vitit 2013, kur e drejta e autorit dhe të drejtat e përfaqëtarëve janë sanksionuar me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Ndërsa kur jemi të politika aktuale në fushën e ndërmjetësimit në fushën e të drejtës së autorit, duhet theksuar se kjo politikë është zbatuar dhe realizuar bazuar në Rregulloren për ndërmjetësimin të Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta, dhe që nga momenti kur kjo Rregullore është miratuar nga ana e qeverisë së Kosovës me 31 janar 2013, është zhvilluar vetëm një procedurë e cila ka përfunduar në fillim të saj pasi që Shogata për Menaxhimin e të Drejtave të Autorit në fushën e veprave audio-vizuale ka bërë një kërkesë për ndërmjetësim e cila iu është drejtuar operatorëve kabllorë dhe të njëjtit nuk u janë përgjigjur propozimit në afatin e paraparë me Ligjin për Ndërmjetësim. Në këtë aspekt vlen të përmendet që Rregullorja për ndërmjetësim të Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta, nuk ka pas dispozita të cilat kanë përcaktuar afatin kohorë brenda të cilit palës e cila bënë propozimin pala tjetër ndaj të cilës drejtohet propozimi duhet të përgjigjet.

Në përgjithësi procedura e ndërmjetësimit e cila zhvillohet në bazë të ligjit të ndërmjetësimit në Republikën e Kosovës, nuk është procedurë shumë e përdorur nga palët për të bërë zgjidhjen e kontesteve ndërmjet tyre, kur jemi te procedura e ndërmjetësimit në ndërmjet palëve (Shoqatave Kolektive dhe Shfrytëzuesve të Drejtës së Autorit si Televizionet, Radiot) është procedurë që zhvillohet në mes të përfaqësuesve të shfrytëzuesve dhe deri më tani kemi pas vetëm dy proceseve të negociatave dhe kontestit për përcaktimin e tarifave të përgjithshme, dhe që tregon që nuk ka dhe nuk mund të ketë shumë konteste. Ajo që është karakteristike e kontesteve në përcaktimin e tarifave të përgjithshme është vlera e tyre e madhe ekonomike dhe ndikimi shoqërorë i kësaj procedure është shumë i madh për faktin që ka të bëjë me përcaktimin e tarifave- vlerës se sa duhet të paguajnë p.sh. televizionet kombëtare dhe lokale, si dhe radiot për shfrytëzimin e materialit të mbrojtur me të drejtën e autorit (si, muzikës, dhe veprave tjera audio-vizuale). Në këtë aspekt ka pak konteste, por të cilat duhet të realizohen në bazë të procedurave të qarta dhe mirë të përcaktuara dhe të bazuara në ligj dhe rregulloren përkatëse.

Vlen të përmendet që sa herë dispozitat e Ligjit për të Drejtën e Autorit nuk e rregullojnë një çështje në lidhje me ndërmjetësimin ajo çështje mund të rregullohet duke përdorë dispozitat e Ligjit për Ndërmjetësim si ligji i cili paraqitet si plotësues dhe që është përdorë edhe për ndërmjetësimin në përcaktim e tarifave të përgjithshme aq sa është paraqitur nevoja deri më tani.

Vlen të përmendet që rol të rëndësishëm në vlerësimin e zbatimit të politikave aktuale dhe rekomandimeve të dhëna nga Komisioni Evropian, përkatësisht, përfaqësuesit të tij përmes misionëve të ndryshme fakt mbledhëse në kuadër të raporteve të progresit si dhe studimit të fizibilitetit të bëra për fushën e të drejtave pronësore intelektuale, respektivisht për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përfaqëtarëve.

Raportet e progresit dhe studimi i fizibilitetit për Republikën e Kosovës, kanë vënë si sfidë për të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta në Kosovë, qëslitjen e krijimit të sistemit të kompensimit të veçantë, kjo sfidë është vlerësuar me kujdes dhe për të njëjtën ZDA ka ndërmarrë veprime të menjëhershme edhe adekuate, duke filluar në këtë mënyre punën e analizimit të praktikave të mira të shteteve anëtare të BE-së. Në raportet e BE-së për Kosovën është paraqitur nevoja, dhe kërkesa që procedura e ndërmjetësimit për kontestet në lidhje me përcaktimin e tarifave të përgjithshme të ndryshohet dhe plotësohet me qëllim që të bëhet harmonizimi i dispozitave që rregullojnë këtë qëslitje me direktivat e BE-së në këtë fushë.

Politika aktuale është krijuar edhe duke u bazuar në bashkëpunimin e ngushtë ndërkombëtar, të realizuar me zyrat si motra në rajon dhe vendet tjera të BE-së, përfshirë këtu një komunikim i mirë me Zyrën Shqiptare për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe një mision fakt mbledhës të BE-së me ekspertë nga Zyra Polake për të Drejtën e Autorit.

Përvoja në shtetet tjera

Kur jemi të përvoja e shteteve tjera, atëherë do theksuar se në kuadër të BE-së qëslitja e ndërmjetësimit është e përcaktuar me Direktivën 98/83/EEC e datës 27 shtator 1993, e cila ka synuar lehtësimin e transmetimit ndërkufitar të programeve audio-vizuale, përkatesisht transmetimit me satelit dhe ritransmetimit kabllorë, përkatesisht me nenin 11 të kësaj direktive e cila ka përcaktuar që shtetet anëtare janë të obliguara të përcaktojnë përfshirjen e ndërmjetësuesve posaçërisht kur kemi të bëjmë me marrëveshje në kuadër të shfrytëzimit të materialit të mbrojtur me të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta, në kuadër të ritransmetimit kabllorë të një transmetimi i cili duhet të realizohet me një marrëveshje gjithëpërfshirëse.

Direktiva përcakton detyrën dhe rolin e ndërmjetësve, e cila është të lehtësojnë procesin e negociatave për të arrit marrëveshje gjithëpërfshirëse. Në këtë direktivë përcaktohet që palët pranojnë propozimin e ndërmjetësit, nëse ato nuk e kundërshtojnë propozimin brenda tre muajve. Gjithashtu, përcaktohet që ndërmjetësit duhet të jenë të paanshëm dhe të pavarur në ushtrimin e punës së tyre.

Megjithatë, do theksuar se përveç këtij obligimi që shtetet anëtare të kanë të caktuar ndërmjetës dhe të parashohin procedure ndërmjetësimi, në përgjithësi procedura e përcaktim të tarifave të përgjithshme është e ndryshme në vende të ndryshme të BE-së dhe ajo që i karakterizon të gjitha shtetet është që tarifat e përgjithshme përcaktohen si fillim me negociata, e nëse negociatat dështojnë atëherë modalitetet të ndryshme vijnë në konsiderim siç është qëslitja e arbitrazhit dhe ndërmjetësimit dhe në disa vende miratimin e tarifave të përgjithshme e bëjnë borde të caktuara. Tarifat e përgjithshme nënkuptojnë shumën e kompensimit që duhet të paguajin shfrytëzuesit për format e ndryshme të shfrytëzimit të lëndëve të mbrojtura. Në vendin tonë procedura e përcaktimit të tarifave të përgjithshme është me sa vijon, tarifat e përgjithshme i propozon bordi drejtues i shoqatës dhe i miraton kuvendi i shoqatës. Tarifat e

propozuara i nënshtrohen negociatave me organizatat e shfrytëzuesve, nëse nuk arrihet marrëveshja gjatë negociatave palët janë të obliguara të propozojnë ndërmjetësesin. Në rast se ndërmjetësimi nuk rezulton me arritje të marrëveshjes, tarifat e përgjithshme i nënshtrohen miratimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës, procedurë kjo që dallon me atë të shumë shteteve të BE-së dhe që është në një mënyrë e veçantë në aspekt të përfshirjes së Qeverisë së Republikës së Kosovës për të miratuar tarifat.

Republika e Kosovës, si shembull kur është bërë hartimi i Rregullores për ndërmjetësim ka marr Republikën e Sllovenisë, dhe si e tillë rregulloja ka marr shumë zgjidhje procedurale dhe përmbajtëse nga Rregulloja për ndërmjetësimin e Kontesteve në fushën e të drejtës së autorit nga Republika Sllovene dhe janë konsultuar ekspertë slloven dhe përfaqësues të shoqatave kolektive nga Sllovenia.

Kapitulli 3. Synimet dhe objektivat

Synimi

Synimi i këtij koncept dokumente është plotësim-ndryshimi i Rregullores për Ndërmjetësim të Kontesteve në Fushën e Drejtës së Autorit, për arsye se është bërë plotësim-ndryshimi i Ligjit për të Drejtat e Përafërta. Andaj në mënyrë që të harmonizohet rregulloja e lartpërmendur me ligjin e lartpërmendur duhet bërë ndryshim-plotësimi i saj.

Përveç arsyes së harmonizimit, bëhet dhe për qëllim të përmirësimit të procedurës në aspekt të pranimit të propozimit për ndërmjetësim nga pala propozues, përkatësisht kur një palë e bënë propozimin për ndërmjetësim, pala ndaj të cilës iu është drejtuar propozimi duhet që brenda një afati të paraparë kohorë të përgjigjet dhe ky afat kohorë nuk është i përcaktuar me rregullore, e që me ligjin për ndërmjetësim është 15 ditë nga dita kur është bërë propozimi. Ky afat kohorë duhet të përfshihet në rregullore.

Objektivat

1. Plotësim ndryshimi i Rregullores për Ndërmjetësim në Kontestet në fushën e drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta, përkatësisht:
 - Plotësim - ndryshim i nenit 7 të Rregullores në bazë të plotësim ndryshimit të nenit 176 paragrafi 4 të Ligjit për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

- Përfshirja e nenit 9, paragrafi 3 të Ligjit për Ndërmjetësim, përkatësisht afatit kohor për përgjigje në propozimin për ndërmjetësim.
- 2. Përfshirja e dy neneve të lartpërmendura në Rregulloren për ndërmjetësim të Kontesteve në Fushën e Drejtës së Autorit, do të ketë efekt pozitiv në përmirësimin e implementimit të kësaj rregulloreje në praktikë, rrijedhimisht edhe në përmirësimin e zgjidhjes së kontesteve.
- 3. Objektivat e parapara janë të arrishme në aspektin e ligji bëries, dhe procesi i hartimit dhe miratimit duhet të kalojë në fazat e parapara me procedurat qeveritare të miratimit të akteve nëligjore. Pas përfundimit të procedurave dhe miratimit të rregullores e njëjta mund të aplikohet dhe zbatohet në praktikë.

Kapitulli 4. Opsionet

Opsioni 1. Status Quo (asnjë ndryshim)

1. Mos ndryshim-plotësimi i Rregullores për Ndërmjetësim të Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit do të ketë efekte negative në tregun e Kosovës. Do të krijohet paqartësi dhe konfuzion në treg, veçanërisht tek palët e kontestit. Kjo si rrijedhoje do të krijojë pasiguri ligjore në treg e cila mund të shpjerë në dëmtim të ekonomisë së vendit, pasi akterët e interesuar për të zhvilluar biznes në Kosovë do të ngurojnë për shkak të paqartësisë së ligjit dhe do i frikësohen procedurave të tej zgjatura gjyqësor në rast të dështimit të procedurës së ndërmjetësimi.
2. Nëse vazhdohet me politikën ekzistuese, konkretisht nëse nuk plotësohet-ndryshohet rregullorja për Ndërmjetësim të Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit, atëherë do të paraqiten probleme në aspektin e zbatimit të drejtave të autorit dhe të drejtave të përfaqëta, konkretisht në zgjidhjen e ftkase të kontesteve në këtë fushë. Problem tjetër do të jetë mosharmonizim i legjislacionit të Kosovës me atë të BE-se dhe vendete të tjera të zhvilluara të botës.
3. Momentalisht Rregullorja për Ndërmjetësim të Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit zbatohet nga organet kompetente për zbatimin e saj, dhe përmes kërkësave për ndërmjetësim nga ana e titullarëve të të drejtave. Mekanizmat kryesor të zbatimit janë të rregulluara me këtë rregullore.

Opsioni 2. Ndryshimi i Politikës Ekzistuese

1. Hapi i pare për ndryshimin e politikës ekzistuese do të ishte ndryshim-plotësimi i rregullores për Ndërmjetësim të Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit, me qëllim të harmonizimit të saj me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, harmonizimin me Legjislacionin e BE-se si dhe të krijimit të një praktike ligjore me efektive dhe me të besueshme. Gjithashtu, plotësimi i Rregullores për ndërmjetësim të Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta, do të bëhej në aspekt të plotësimit me dispozita shpresë në kuadër të përcaktim të procedurës për të fillimin dhe përfundimin e procesit të ndërmjetësimit.
2. Aprovimi i ndryshim-plotësimit të rregullores për Ndërmjetësim të Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit, do të rregullonte në mënyrë specifike çështjet lidhur me procedurën e ndërmjetësimit të kontesteve në fushën e të drejtave të autorit, me konkretisht të afateve kohore. Do të përcaktohej afatin kohor se sa kanë kohë palët për të kundërshtuar propozimin për zgjidhje të kontestit nga ndërmjetësuksi, dhe rregullimin e afatit kohor se sa kanë kohë palët për të pranuar ofertën për të hyre në procedurë të ndërmjetësimit.
3. Përgjegjës për zbatimin e rregullores për ndërmjetësimin e kontesteve në fushën e të drejtës së autorit, do të jetë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Duke pas parasysh që të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta, për nga natyra janë të drejta pronësore, pra nga sfera civile e të drejtave, atëherë përgjegjësia kryesore e mbikëqyrjes së zbatimit të këtyre të drejtave bie mbi vetë titullarët e të drejtave, të cilët duhet të iniciojnë vetë procedurën për ndërmjetësim dhe të kërkojnë zbatimin e rregullores. Në momentin kur fillon procedura e ndërmjetësimit ajo zbatohet sipas rregullores edhe nga vetë ndërmjetësit dhe Zyra për të Drejtën e Autorit e cila e luan rolin e sekretariatit në procesin e ndërmjetësimit.
4. Për mos respektimin e Rregullores për ndërmjetësim të Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta, nuk janë paraparë sanksione pasi që procesi i ndërmjetësimit është një proces që zhvillohet vetëm me vullnetin e palëve dhe nëse palët nuk dëshirojnë vazhdimin e këtij procesi ato mund që fillimisht mos të futen në procesin e ndërmjetësimit, dhe nëse janë përfshirë në këtë proces palët mund të dalin në çdo fazë nga procesi i ndërmjetësimit. Ndërsa kur jemi te Ligji për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, janë të parapara sanksione me vetë LDADP, respektivisht neni 190 i cili parashih sanksione për shkeljen e të drejtave të autorit, konkretisht personi juridik dënohet me gjobë nga dymijtë (2000) euro deri në dhjetë mijë (10000) euro. Ndërsa, personi përgjegjës i personit juridik, dënohet nga dymijtë (2000) euro. Neni 191, i LDAD parashih sanksione për shmangien e masave teknologjike dhe atë dënime me gjobë nga pesëmijtë (5000) deri në njëzet e pesëmijtë (25000) euro për personat juridik. Ndërsa, personi që bënë shmangien e masave teknologjike dënohet me gjobë nga njëmijtë (1.000) deri pesëmijtë (5.000) Euro.
5. Ndryshim-plotësimi i rregullores për Ndërmjetësim të Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit, nuk paraqet nevojë për personel

shtesë, përveç të trajnimeve të cilat do të mbahen për stafin e ZDA-së, dhe këto trajnime mund të mbahen nga drejtori i Zyrës për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

6. Nuk ka nevojë për program shtesë, trajnimet do të bëhen në vendin e punës nga ekspertë të BE-së në kuadër të programit të Komisionit Evropian për asistencë teknike me anë të aplikimeve që mund të bëhen nga ZDA.

7. Ndryshim-plotësimi i rregullores për ndërmjetësim të Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit kërkon fushatë edukuese dhe vetëdijesuese, përkatësisht kërkon një trajnim që duhet të mbahet për ndërmjetësit që i ka emëruar qeveria e Republikës së Kosovës, për të i njoftuar ata me ndryshimet në Rregulloren për ndërmjetësim të Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta.

8. Fushata do të realizohet përmes kampanjave informuese dhe për realizimin e saj përgjegjës është MKRS, respektivisht Zyra për të Drejtat e Autorit. Kampanja do të realizohet pas aprovimit të ndryshim-plotësimit të Rregullores për ndërmjetësim të Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit pas aprovimit të Rregullores nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

9. Për zbatimin e rregullores, përgjegjës do të jenë institucionet e njëjta të evidentuara në pikën 3 të opsionit 2.

10. Për ndryshimin e politikës ekzistuese, konkretisht nevojitet që pas miratimit të rregullores për ndërmjetësim të Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit, ndërmerrën masa për zbatimin e kësaj rregullore duke filluar me përgatitjen e institucioneve të zbatimit të saj, ZDA-së, ndërmjetësve dhe Shogatave Kolektive për menaxhimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të përafërta.

Opsioni 3. Ndryshimi i gjasjes ekzistuese të zbatimit

1. Nëse nuk bëhet ndryshimi i rregullores për ndërmjetësim të Kontesteve në Fushën e të Drejtës së Autorit dhe vazhdohet me zbatimin e politikës ekzistuese, do të krijohen probleme në implementimin e procedurës së ndërmjetësimit, konkretisht në afatet kohore të pranimit të zgjidhjes së kontestit dhe në afatin kohorë për pranimin e ofertës nga pala tjetër për të filluar procedure e ndërmjetësimit. Kjo do kishte si pasojë, mos-realizimin efektiv të rregullores përkatëse.

2. Për mos përmbyllje të obligimit të marrë sigurisht se përgjegjës do të ishte fillimisht Zyra për të Drejta të Autorit dhe të Drejtat e Përafërta (MKRS), por edhe Qeveria e Kosovës për normin me akt nënligjor të kësaj të drejte të përcaktuar me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

3. Trajinimet dhe programet tjera për qasjen ekzistuese të zbatimit nuk do të kanë efekt në adresimin e problemit. Adresimi i problemit bëhet vetëm me ndryshimin e rregullores, përkatësisht politikës ekzistuese dhe nuk mund të realizohen përmes ndryshimi të qasjes së zbatimit.

Kapitulli 5. Përmbledhje e opsioneve

Përmbledhja e Opsioneve			
Karakteristikat kryesore	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Karakteristikat kryesore të opsionit	Mos-normimi me akt nënligjor i të drejtës për ndërmjetësim të kontesteve në fushën e drejtës së autorit, konkretisht në rregullimin e afateve kohore të procedurës së ndërmjetësimit. Përkatësisht rregullorja nuk do të ishte në harmoni me Ligjin për të drejtën e autorit dhe me direktivat e BE-së.	Ndryshim-plotësimi i aktit nënligjorë në fuqi, caktimi i afateve kohore të procedurës së ndërmjetësimit	-//-
Segmenti i Popullsisë/sektori/rajoni i shënjestruar	Të gjitha titullarët e të drejtave, përdoruesit e të drejtave; shoqatat për menaxhim kolektiv	Të gjitha titullarët e të drejtave, përdoruesit e të drejtave; shoqatat për menaxhim kolektiv	
Karakteristikat e zbatimit - kush është përgjegjës - një resor i Qeverisë (cili), sektor privat, qytetarët	Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta; Shoqatat për Menaxhim Kolektiv; ndërmjetësit dhe Shfrytëzuesit e materialit – lëndës së mbrojtur me të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta	Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta; Shoqatat për Menaxhim Kolektiv; ndërmjetësit dhe Shfrytëzuesit e materialit – lëndës së mbrojtur me të drejtën e autorit dhe të drejtat e përafërta	-//-

Administrimi ose zbatimi i programit ose shërbimit	Zyra për të Drejtën e autorit dhe të Drejtat e Përafërta e luan rolin e sekretariatit të procesit të ndërmjetësimit, vetëm atëherë kur i njëjtë zhvillohet në procedurën e caktimit të tarifave të përgjithshme.	Zyra për të Drejtën e autorit dhe të Drejtat e Përafërta e luan rolin e sekretariatit të procesit të ndërmjetësimit, vetëm atëherë kur i njëjtë zhvillohet në procedurën e caktimit të tarifave të përgjithshme.	-//-
Ligjet, aktet nënligjore, ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve ekzistuese si dhe zbatimi dhe dënimet	Rregullore Nr. 05/2013 Për Ndërmjetësim Të Kontesteve Në Fushën E Të Drejtës Së Autorit Dhe Të Drejtave Të Përafërta Në Ministrinë E Kulturës, Rinisë Dhe Sportit	Rregullore Nr. 05/2013 Për Ndërmjetësim Të Kontesteve Në Fushën E Të Drejtës Së Autorit Dhe Të Drejtave Të Përafërta Në Ministrinë E Kulturës, Rinisë Dhe Sportit	-//-
Stimulimet ose mos-stimulimet ekonomike-subvencionet ose taksat	-//-	-//-	-//-
Fushatat e edukimit dhe komunikimit	Për titullarët e të drejtave; shogatat për menaxhimin kolektiv të të drejtave, ndërmjetësit; shfrytëzuesit e të drejtave; për institucionet zbatuese të ligjit dhe për qytetarët në përgjithësi	Për titullarët e të drejtave; shogatat për menaxhimin kolektiv të të drejtave, ndërmjetësit; shfrytëzuesit e të drejtave; për institucionet zbatuese të ligjit dhe për qytetarët në përgjithësi	-//-
Afatet kohore – kur hyn në fuqi opsioni	Rregulloria aktuale ka hyrë në fuqi me 12.02.2013	Pas miratimit dhe plotësimit ndryshimit se rregullores aktuale nga Qeveria e Kosovës.	

Kapitulli 6. Analiza e opsioneve

Përfitimet

1. Opsioni i 1 (pare), (status quo): Në rast të zgjedhjes të këtij opsioni, nuk do të ketë përfitim për asnjë palë.
2. Opsioni i 2 (dyte): Se pari ky opsion harmonizon Rregulloren për Ndërmjetësim të Kontesteve në fushën e të Drejtës së Autorit me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, dhe Legjislacionin e BE-se. Përveç harmonizimit, ky opsion do të ketë implikime pozitive për palët në kontest, pasi do të qartësoj afatet kohore të procedurës së ndërmjetësimit, duke siguruar kështu një implementim me efikas të procedurës së ndërmjetësimit, kjo arrihet duke harmonizuar rregulloren me nenin e ri 25 të Ligji Nr. 05/L-047 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, me të cilin nen është ndryshuar neni 176 përkatësisht paragrafi 4, i cili është riformuluar si vijon “*ndërmjetësuesi mund të paraqesë palëve propozim për zgjedhjen e mosmarrëveshjes. Supozohet që palët e pranojnë propozimin për zgjidhje të mosmarrëveshjes, në rast se asnjë prej tyre nuk ka shprehur kundërshtim, brenda një periudhe tre (3) muajore nga dërgimi i propozimit*”. Në këtë aspekt do të rregullohej edhe afati kohorë gjatë së cilit pala ndaj së cilit është drejtuar propozimi për ndërmjetësim do të duhej të i përgjigjej palës që ka bërë propozimin e që me Ligjin për Ndërmjetësim është 15 ditë pune.

3. Opsioni i 3 (tretë): Në rast të implementimit të opsionit të tretë, nuk do të ketë ndryshim-plotësimin të rregullores aktuale, si rriçdhoje nuk do të mund të qartësohen afatet kohore të procedurës se ndërmjetësimit dhe do të vazhdohet me politikën ekzistuese ku në fakt Rregullorja për ndërmjetësim nuk do të ishte e harmonizuar me Ligin për të Drejtën e Autorit dhe as me direktivat evropiane të fushës.

Pasojat negative

1. Opsioni i 1 (pare), (status quo): Ndikime negative në procesin e integritimit evropian, për shkak se do të vazhdonte të ishte në fuqi një rregullore me dispozita të cilat nuk janë në harmoni me direktivat e BE-së dhe gjithashtu edhe me legjislacionin e Republikës së Kosovës për të drejtën e autorit dhe drejtave të përafërta. Negativisht do të ndikonte në titullarët e të drejtave të përafërta, dhe në institucionin e ndërmjetësimit për kontestet e së drejtës së autorit, për shkak të konfuzionit që do të mund të shkaktonte mos-përcaktimi i sakte i afateve kohore.
2. Opsioni i 2 (dyte): Nuk ka pasoja negative nëse vendoset sipas këtij opsioni, përkatësisht do të ndryshohej politika ekzistuese

përmes plotësimit-ndryshimit të Rregullores për ndërmjetësimin e kontesteve në fushën e drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përfërta.

3. Opsioni i 3 (tretë): Vlen i njëjti përshkrim i pasojave negative si në opsionin e parë, vetëm duke bërë ndryshimin e qasjes nuk mund të zgjidhet problemi dhe nuk do të mund të gartësohen afatet kohore të procedurës së ndërmjetësimit dhe do të vazhdohet me politiken ekzistuese

Efekti shpërndarës

1. Plotësimi dhe ndryshimi i rregullores për ndërmjetësim të kontesteve në fushën e së drejtës së autorit do të sjellë harmonizim të rregullores me LDADP-ne, dhe përfitime për titullarët e të drejtave dhe krijuesit, si dhe vet institucionin e ndërmjetësimit. Ky plotësim-ndryshim do të krijoj siguri ligjore në treg për palët, e cila do të ndikojë pozitivisht në industrinë kreative të vendit, respektivisht inkurajim të prodhimit të materialeve që mbrohen me të drejtën e autorit ne fushën e filmit po ashtu edhe në atë librit, pasi që procedura për kompensim do të kishite në dispozicion një rregullore më të avancuar dhe të përshatur me ligjin në fuqi.

2. Përfitimet dhe pasojat negative të elaboruara, lidhur me të gjitha opsionet e konsideruara nuk janë të lidhura me rajone apo pjesë të caktuara të Republikës së Kosovës, por ato kanë efekt të përgjithshëm në tërë territorin e vendit, përkatësisht përfitimet dhe pasojat janë të ndërlidhura me mbajtësit e të drejtave dhe shfrytëzuesve.

3. Ndikimet e opsioneve të konsideruara janë të njëjta për të gjitha moshat dhe veprojnë njëjtë në të dy gjinitë, pra nuk ka efekte dalluese në baza të gjinive apo moshës.

Kosto

Për implementimin e këtyre opsioneve të propozuar nuk krijohen kosto shtesë buxhetore përveç atyre të parapara tashmë me Ligjin mbi Buxhetin për vitin 2018. Vazhdimi i aplikimit të politikave aktuale dhe ndryshimi i politikave aktuale nuk paraqet ndryshime në shpenzimet buxhetore.

Për më tepër, asnjëri nga opsionet e hartuara nuk paraqet diferencë në gjenerimin e të hyrave dhe në alokimin e shpenzimeve. Po ashtu, nuk pritet financim nga donatorët.

Kapitulli 7 - Konsultimi

Konsultimi me ekspertë (jashtë Qeverisë, në universitete ose agjenci).

Ioannis Kikkis, ekspert kryesor për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përfaqëta, në kuadër të Projektit për Forcimin e të Drejtave Pronësore Intelektuale në Kosovë, projekt ky i financuar nga Komisioni Evropian. Z. Kikkis ka propozuar se Kosova duhet pajtëtar të plotësojë-ndryshoj rregulloren aktuale për ndërmjetësim të kontesteve në fushën e së drejtës së autorit, me qëllim të përfshirjes së dy neneve të përfundara dhe harmonizimit të rregullores me direktivat e BE-së.

Kapitulli i 8: Krahësimi i opsioneve (vlerësimi i pasojave të secilit opsion)

1. Përfutimet sipas opsionit të parë janë të ndërlikdhura me ruajtjen e gjendjes ekzistuese, respektivisht mos ndryshimit të politikës aktuale, realisht në këtë opsion nuk ka ndonjë përfutim për bartësit e të drejtave të autorit, dhe as për institucionin e ndërmjetësimit në përgjithësi.

Ndërsa pasojat negative, do të reflektoheshin kryesisht për titullarët e të drejtave të autorit, institucionin e ndërmjetësimit dhe pastaj në harmonizimin me ligjin nacional si dhe avancimin e procesit të integritimit evropian, si pasojë e mos-harmonizimit me legjislacionin e BE-së.

2. Opsioni i dytë do të sillte më shumë përfutime, kryesisht është vështirë të gjendet ndonjë efekt negativ. Ndërsa, sa i përket efekteve pozitive, ato do të jenë të shumta, harmonizimi me legjislacionin nacional si dhe me atë të BE-së, përmirësimin e procedurës së ndërmjetësimit duke e bërë atë kështu më efikase, si dhe si efekt zinxhir do të ishte inkurajimin e prodhimit të materialeve që mbrohen me të drejtën e autorit në fushën e filmit po ashtu edhe në atë të librit. Opsioni i dytë ka efekte pozitive të shpërndarjes, kryesisht në industrinë kreative, për shkak që do të ndikojë në stimulimin e krijimtarisë kulturore, zhvillimin ekonomik. Shpërndarja dhe efektet e saj sipas opsionit të dytë nuk do të bëjnë dallime në aspektin rajonal apo territorial, por përfshijnë tërë territorin e Kosovës. Efektet nuk kanë dallime të cilat mund të ndjehen nga grupe të caktuara bazuar në moshe apo në gjini, por kanë ndikim të përgjithshëm pozitiv. Gjithashtu ky opsion do të përmirësoj procedurën e ndërmjetësimit, duke rregulluar afatet kohore kështu shmangen keqkuptimet potenciale në mes palëve dhe iu ofron siguri me të madhe ligjore palëve.

3. Opsioni i tretë nuk do të kishte përfutime, njëjtë sikur me opsionin e parë, por edhe efekti i pasojave negative do të ishte i njëjtë dhe efektet e shpërndarjes do të ishin të njëjta me opsionin e parë, të ndërlikdhura me ruajtjen e status qos dhe mos plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për ndërmjetësimin e kontesteve në fushën e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përfaqëta.

4. Nga të tre opsionet e lartë-përmendura, ai më i duhuri do të ishte opsioni i dytë, pra plotësim-ndryshimi i rregullores për ndërmjetësim të kontestëve në fushën e së drejtës së autorit. Ky opsion do të ishte më i qëlluar dhe i rekomanduar për arritjen e synimit dhe objektivave të parapara në Kapitullin 3.

Kapitulli 9: Rekomandimi

1. Rekomandohet opsionin i dytë, respektivisht plotësim-ndryshimi i rregullores për ndërmjetësim të kontestëve në fushën e së drejtës së autorit, me qëllim të harmonizimit me LDADP dhe legjislacionin e BE-se si dhe përcaktimi për zgjidhjet më të mira për përmirësimin e procedurës së ndërmjetësimit në fushën e të drejtës së autorit, duke marrë për bazë praktikën më të mirë të rajonit dhe më gjerë.
2. Procedurat për hartimin e plotësim-ndryshimit të rregullores për ndërmjetësim të kontestëve në fushën e së drejtës së autorit do të kryesohen nga ana e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, Zyra për të Drejtat e Autorit, në bashkëpunim me institucionet dhe grupet e interesit të arrihen objektivat e parapara.
3. Brenda vitit 2018 duhet të përfundoj procedura e hartimit dhe aprovimit të rregullores për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për ndërmjetësim të kontestëve në fushën e së drejtës së autorit.
4. Nuk do të ketë ndryshime në koston e zbatimit të ligjit aktual, rregullorja do të sjellë të hyra për titullarët e të drejtave dhe për buxhetin e shtetit, pasi të hyrat do të tatohen dhe do të mundësojnë zgjidhje me të lehtë të kontestëve në lidhje me përcaktimin e tarifave të përgjithshme për shfrytëzimin e lëndës të mbrojtur me ligjin për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta.
5. Nga momenti i aprovimit të koncept dokumentit do të formohet grupi punues i cili do të dërgon edhe më shumë informata për draft rregulloren për plotësimin dhe ndryshimin e rregullores për ndërmjetësim të kontestëve në fushën e së drejtës së autorit.

Kapitulli 10: Komunikimi

1. Akerët kryesorë të fushës janë në djepi për fillimin e procedurave lidhur me hartimin e koncept dokumentit. Ata do të jenë të njoftuar për çdo veprim të ri në këtë aspekt përmes shkrësive zyrtare dhe e-mailave.
2. Me akterët e prekur do të komunikohet bazuar në procedurat e parapara me akte nën-ligjore, varësisht nga faza e zhvillimit të procedurës.
3. Konsultimet do të realizohen për secilën fazë të procesit, duke filluar nga momenti i aprovimit të koncept dokumentit.

Kapitulli 11: Projekt vendimi i Qeverisë

1. Aprovohet Koncept-dokumenti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit për Ndërmjetësimin në fushën e të Drejtës së Autorit dhe të Drejtave të Përafërta.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.